



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2019:091119

Datë: 24.06.2019

Numri i dokumentit: 00373657

PKR.nr. 26/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE GJAKOVE –Departamenti për Krime te Rënda gjyqtari Shaqir Zika, Kryetari i Trupit Gjykses, me pjesëmarrjen procesmbajtëses Bute Ramosaj, në lëndën penale kundër të akuzuarit E.G.Ll. nga Gjakova, ku dhe jeton për shkak të veprës penale blerja, posedim, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar të narkotikeve substanca psikotrope ose analoge nga neni 273 prg 1 te KPRK-se, i akuzuar me aktakuzën e Prokurorisë Themelore ne Gjakove-Departamenti i Krimeve te Rënda, PP/I.nr. 34/2019, datë 26.04.2019, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datën 11.06.2019, me pjesëmarrjen e Kryeprokurorit te Prokurorisë Themelore ne Gjakove, Ali Selimaj, të akuzuarit E.Ll. nga Gjakova, murrë dhe publikisht shpalli me dt. 14.06.2019, ndërsa me dt. 24.06.2019 përpiloi këtë:

AKT GJYKIM

I akuzuari: E.Ll., data e lindjes...,Gjakove, ku dhe jeton, nga i ati G. dhe ëma F., e lindura Sh., i divorcuar, ati i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, numër personale...,Ashkali, Shtetas i R. së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak së:

Pa autorizim ka poseduar me qellim te shitjes substancë narkotike e cila me Ligj është e shpallur si narkotik ne atë mënyrë qe ditën kritike me dt. 12.03.2019 gjate realizimit te planit operativë “ stop drogave neper dhe përreth shkollave “ nga ana e DHTN-se, ne Gjakovë, pikërisht ne Lagjen e quajtur “S.“ janë ndaluar personat S.B., B.M. dhe F.M. ashtu qe gjate kontrollit dhe bastisjes se tyre nga ana e policisë e të njëjtit janë gjetur dhe sekuestruar gjithsej 2.46gr, substance narkotikë e cila nga raporti i analizës se narkotikeve i përpiluar nga ana e Drejtorisë se hetimeve me Narkotike ne Gjakovë, me dt.19.03.2019, ka rezultuar te jetë substancë narkotike e llojit “ marihuana “ e te cilën substancë narkotike dyshohet se e kane blerë për 5 (pese) € nga i pandehuri E.Ll.

- Këso dore ka kryer veprë penale blerja, posedim, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar të narkotikeve substanca psikotrope ose analoge nga neni 273 prg 1 te KPRK-se,

Andaj Gjykata me aplikimin e neneve 6.17, 41,46, 49, 50,51,52,62,73, dhe nenit 273 prg.1 te KPRK-së dhe neneve 359 par. 2, te KPPK-se , të akuzuarit i gjykon me :

DENIM ME KUSHT DHE DENIM ME GJOBE

Të akuzuarit E.Ll. për veprë penale blerja, posedim, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar të narkotikeve substanca psikotrope ose analoge nga neni 273 prg 1 te KPRK-se, i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, i cili dënim nuk do të ekzekutohet posë qe i akuzuari në afate prej 3 (tre) vite, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale, dhe dënimin më gjobe në shumë prej 300(tre qind) €, e cila gjobe nuk do te ekzekutohet po qe se i akuzuari ne afat prej 3 (tre) vite, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

Të akuzuarit i shqiptohet dënimi plotësues konform nenit 69 prg. 1 lidhur me nenin 273 prg 5 te KPPK-se, i konfiskohet substanca narkotike e llojit “ marihuna “ ne peshe prej 2.46 gr,

I akuzuarit E.Ll., është liruar nga pagesa e shpenzimeve te procedurës dhe paushallit gjyqësore pasi qe i njëjti është përfitues i ndihmës sociale.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Gjakovë-Departamenti për krime të Renda, ka ngritur aktakuzën PP/I.nr. 34/2019, datë 26.04.2019 kundër të akuzuarit E.G.Ll. nga Gjakova, ku dhe jeton për shkake të veprës penale blerja, posedim, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar të narkotikeve substanca psikotrope ose analoge nga neni 273 prg 1 te KPRK-se,

Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar me dt.11.06.2019, kur prezent kane qene Kryeprokurori i shtetit Prokurorisë Themelore ne Gjakove Ali Selimaj, dhe i akuzuari E.Ll., dhe se ka pasur kushte për mbajtje te shqyrtimit fillestar .

Pas leximit te aktakuzës ne seancën e shqyrtimit fillestar, Gjykata është bindur se i akuzuarit E.Ll. ka kuptuar aktakuzën, u është dhënë mundësia qe te deklarohet për pranimin ose mos pranimin e fajësisë.

Me këtë rast Gjykata ka udhëzuar te akuzuarin për rendësin dhe pasojat e pranimit te fajësisë ne kuptim ne nenit 326 te KPPK-se, kështu qe pas shpjegimeve te bere nga ana e Kryetarit te Trupit Gjykuese, i akuzuar E.Ll. ka deklaruar se është plotësisht i vetëdijshëm për rendësin e pranimit te fajësisë dhe ka shtuar se ky deklarim paraqet shprehje e vullnetit te tij te lire, pasi qe është kryes i veprës penale andaj ne tërësi ka pranuar fajësinë sipas te gjitha pikave te aktakuzës, dhe se pranimi i fajësisë është i mbështetur ne provat te cilat i janë ofruar Gjykatës ne aktakuze dhe atë nga raporti i oficerit Sh.S. me numër te rastit 2019- DHTN-206, te dt.11.03.2019, dëftesa mbi konfiskimin e pronës me numër te njëjte te datës se njëjte, raporti i analizës se narkotikeve me numër 2019- 206, te dt.19.03.2019, nga e cila ekspertizë

ka rezultuar se kemi te bëjmë me substancë narkotike te llojit “marihuna“ si dhe foto te substancës narkotike.

Pas deklarimit te akuzuarit E.Ll., për pranimin e fajësisë Kryetari i trupit gjykues kërkoj qe mendimin qe te jep Prokurori i Shtetit.

Kryeprokurori i PTH DP ne Gjakove, Ali Selimaj ka deklaruar se: pas deklarimit te akuzuarit ne këtë seancë te shqyrtimit fillestar i cili ka pranuar fajësinë për vepër penale qe i vihet ne barrë sipas aktakuzës te njëjtit nga ana e Kryetarit te Trupit Gjykuese i janë shpjeguar te gjitha te drejtat ligjore, për favoret dhe pasojat e pranimit te fajësisë dhe aktakuza mbështet ne provat materiale siç është dëftesa mbi konfiskimin e pronës, raporti i analizës se narkotikeve e cila ka rezultuar qe është e llojit “marihuana “ foto e substancës narkotike dëshmitë e dëshmitarëve F.M., dhe B.M. dhe S.B., andaj i ka propozuar Kryetarit te Trupit Gjykuese qe te aprovoi pranimin e fajësisë së të akuzuarit. Dhe gjate shqiptimit te dënimit Gjykata te ketë parasysh te gjitha rrethanat lehtësuese dhe renduese.

Po ashtu i ka propozuar Gjykatës, qe ti shqiptohet dënimi plotësues te konfiskohet substanca narkotike ne peshë te përgjithshëm prej 2.46 gr,

I akuzuari E.Ll., ka deklaruar e pranon fajësinë sipas aktakuzës, duke deklaruar se: i njëjti ka qene përdorues i narkotikeve dhe është e vërtete qe këtu dëshmitarit S.B. ja kam dhëne narkotikun pa kompensim mirëpo ai mi ka lenë 5 (pese)€ dhe me ka thëne qe te pije një kafe dhe për ketë jam penduar thelle, duke cekur se gjersa ka qene në Bosnje ka konsumuar narkotike “marihuana“ dhe qe 4 vite është kthyer ne Kosovë, është divorcuar nga bashkëshortja dhe kujdeset për tre fëmijët dhe jeton nga ndihma sociale, vuan nga sëmundja e epilepsisë andaj ka kërkuar qe ti shqiptohet një dënim sa me i bute ka premtuar qe ne te ardhme nuk do te kryej vepra te tilla apo te ngjashme penale.

Ne vijim, Gjykata duke shqyrtuar pranimin e fajësisë nga ana e te akuzuarit vlerësoi se pranimi i fajësisë paraqet shprehje te vullnetit te lire te akuzuarit, pasi qe i njëjti ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit te fajësisë, dhe pranimi i fajit është bere pas shpjegimeve nga ana e Kryetarit te Trupit Gjykuese dhe ky pranim mbështetet ne provat qe janë në aktakuzë konform nenit 326 te KPK-se.

Duke pasur parasysh Gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e te akuzuarit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethane nga neni 248 te KPPK-se si dhe faktin se janë plotësuar kushtet nga neni 326 te KPPK-se e këtë qeshje penale nuk është zbatuar procedura e provave .

Me faktet e ofruara si dhe pranimin e fajit nga të akuzuarit është vërtetuar gjendja faktike si ne dispozitiv I, te këtij aktgjykimi, andaj ne veprimet e te akuzuarit E.Ll. ekzistojnë te gjitha tiparet e veprës penale nga neni 273 prg. 1 te KPRK-se, për te cilat vepër penale i akuzuari është penalisht përgjegjës dhe i është shqiptuar dënimi si ne dispozitivë te këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes se dënimit Gjykata ka pasur parasysh te gjitha rrethanat qe ndikojnë ne llojin dhe lartësinë e dënimit, si rrethanë lehtësuese ka marrë parasysh pranimin e fajësisë nga te akuzuarit, sjelljen korrekt gjate terë procedurës, është mbajtës i vetëm i familjes i ati i tre fëmijëve te miture, gjendjen e tij ekonomike, jeton nga ndihma sociale, me herët nuk ka qene i gjykuar, ka dhëne premtimin qe ne te ardhëm nuk do te kryej vepra te tilla apo

te ngjashme penale, andaj Gjykata te njëjtit i ka shqiptua dënim si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi, me shpresë dhe bindje se me dënimet e shqiptuar do te arrihet qëllimi i dënimit i paraparë më dispozitat e nënti 41 te KPK-së.

Vendimi mbi konfiskimin narkotikut është ne pajtim me nenin 69 prg.1 lidhur me nenin 273 par.5 te KPRK-se.

Vendimi mbi lirimin e shpenzimet të procedurës penale dhe ne emër te paushallit gjyqësor bazohet ne dispozitat e nenit 453 par 4 të KPPK-se, i njëjti është përfitues i ndihmës sociale e kjo është vërtetuar nga kartela e ndihmës sociale me numër te regjistrimit 44400 te dt. 01.07.2018, lëshuar nga Qendra për Pune Sociale ne Gjakovë.

Nga aresyrat e cekura me larte dhe me zbatimin e neni 365 par. 1 te KPPK-se është vendosur ne dispozitave te këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NE GJAKOVË,- Departamenti Për Krime të Rënda,
PKR.nr. 26/2019, dt 24.06.2019**

**Procesmbajtësja
Bute Ramosaj**

**Kryetari i Trupit Gjyqësor
Shaqir Zika**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund te parashtrohet ankesë, nëpër mjet kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit ne Prishtine ne afati prej 15 ditëve nga dita e pranimit te aktgjykimit.

Numri i lëndës: 2019:091119
Datë: 24.06.2019
Numri i dokumentit: 00373657